



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**05.09.2012**

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Znj. Irma Baraku pret Z. Nils Muižnieks, Komisioner për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Znj. Irma Baraku priti sot me datë 05.09.2012 në ambientet e institucionit të Komisionerit, Z. Nils Muižnieks, Komisioner për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës.

Fillimisht, Komisioneri u ndal në një përshkrim të përgjithshëm të aktivitetit të Zyrës së Komisionerit dhe ngritjen institucionale. Aktiviteti i Zyrës është i fokusuar në dy drejtime:

1. Trajnimin e stafit të Komisionerit;
2. Krijimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve me institucionet e tjera dhe Organizatat Jofitimprurëse, që ushtrojnë aktivitetin në mbrojtjen e të drejtave të Njeriut.

Zyra e Komisionerit, përveç ankesave të ardhura nga subjektet e parashikuar në ligj, i jep një rëndësi të veçantë edhe hetimeve me nismën e vet (ex-officio), pas marrjes së informacioneve nga media dhe OJF-të. Kjo edhe për faktin se duke qenë një institucion relativisht i ri, ndërhyrja në rastet kur dyshohet për diskriminim është e nevojshme. Ky fakt u vlerësua nga Z. Nils Muižnieks. Gjithashtu, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut u njoh me Planin Strategjik dhe Planin e Veprimit të Zyrës së Komisionerit, I cili shtrihet në një afat 3 vjeçar. Komisioneri theksoi se në këto dokumente, grupet vulnerabël që gëzojnë një mbrojtje të veçantë dhe që janë të parashikuar në mënyrë të shprehur në objektivat e ardhshëm strategjik janë:

1. Komuniteti LGBT
2. Komuniteti Rom
3. Personat me Aftësi të Kufizuara
4. Gratë

Pas kësaj, fokusi i diskutimeve u përqendrua tek çështjet që ka trajtuar Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas fushave dhe shkaqeve të diskriminimit.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
ëeb: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Së fundmi, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut shprehu konsideratën e tij për zhvillimet institucionale si dhe angazhimin e Tij për të mbështetur institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

## **Sektori i Marrëdhënieve me Publikun**



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
ëeb: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)